

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po gjykohet lufta jonë": Në Kosovë, zemërimi ndaj vendimit të Hagës vazhdon të vlojë
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/22/po-gjykohet-lufta-jone-ne-kosove-zemerimi-ndaj-vendim-it-te-hages-vazhdon-te-vloje/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 09:00:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	26a2c0ba69038b508b8f504289d71ef43435083a966cf6c92c01ae1e9acebebe
TEKSTI	9c0691575f3adb85b85b49c4e6eb8b5d2c990d2cbdc0fa086bb26b0338a457a4
PAMJA	201d7e6aa53dbd38efea0bd29f23b09d2225b97b3f52bb1fbd4b831102ced928

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3d3d44b543ccab26d1e2322177e584744f8213d64c888c765562fec75c92dce3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3d3d44b543ccab26d1e2322177e584744f8213d64c888c765562fec75c92dce3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Rajoni

“Po gjykohet lufta jonë”: Në Kosovë, zemërimi ndaj vendimit të Hagës vazhdon të vlojë

Mijëra njerëz mbledhen dy herë në ditë në sheshin kryesor të Prishtinës për të protestuar kundër vendimit të javës së kaluar, i cili shpalli fajtorë për krime lufte katër ish-udhëheqës të UÇK-së; ndërkohë, disa politikanë po kërkojnë ndërhyrje legjislative për të ndryshuar mënyrën se si funksionon gjykata e Hagës.

nga Xhorxhina Bami — 1 day më parë në Rajoni Koha e leximit: 4 min lexim

AA 0



Protestë kundër vendimit të Hagës në Prishtinë, 18 shtator 2026. Foto: BIRN/Ardita Zeqiri.

Të përplotur dhe të zemëruar, mijëra shqiptarë etnikë kanë zhvilluar protesta të rregullta në Prishtinë që kur një trup gjyqtarë ndërkombëtarë në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë dënoi javën e kaluar për krime lufte katër ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK.

Këtu, në kryeqytetin e Kosovës, vendimi shihet gjerësisht si një padrejtësi ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, të cilët gjatë luftës së viteve 1998–1999 luftuan kundër shtypjes dhe spastrimit etnik, si dhe për vetëvendosjen dhe vlerat demokratike.

“Sot, të rinjtë e Kosovës jetojnë në një shtet të lirë, të pavarur, demokratik dhe multietnik”, deklaroi Donard Humolli, përfaqësues i Parlamentit Studentor të Universitetit të Prishtinës, gjatë një marshimi të zhvilluar të hënën nga studentët e universiteteve publike.

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Dhomat e Specializuara ka këmbëngulur se në gjyq ishin individët dhe jo UÇK-ja apo lufta e saj. Por shumë shqiptarë të Kosovës nuk e shohin kështu këtë çështje.

Ndërsa protestuesit brohorisin “UÇK!” në një tubim të dielën, Çlirimtar Haziri, një nga organizatorët, këmbënguli se katër të pandehurit “nuk janë atje si individë – për ne, atje, në Hagë, po gjykohet një pjesë e historisë sonë, e luftës sonë”.

Haziri tha se protestat do të vazhdojnë derisa të jepet një vendim pafajësie në apel. Ai tha se protestuesit po kërkojnë gjithashtu ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës – baza ligjore mbi të cilën ekziston gjykata – dhe po i bëjnë thirrje qeverisë të vazhdojë mbështetjen e saj financiare për katër të pandehurit gjatë procesit të apelimit.

Kërkesa për ta “sjellë gjyqin në Kosovë”



Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026



Studentët marshojnë në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, 21 shtator 2026. Foto: BIRN/Valon Fana.

Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi u dënuan përkatësisht me 25, 25, 18 dhe 13 vjet burg. Ata u shpallën fajtorë për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes, të kryera nga prilli i vitit 1998 deri më 20 qershor 1999, në Kosovë dhe në dy lokacione në Shqipëri. Ata u shpallën të pafajshëm për krime kundër njerëzimit.

Të hënën, grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, PDK – partia që shihet gjerësisht si e dalë nga UÇK-ja dhe që në të kaluarën është drejtuar si nga Thaçi, ashtu edhe nga Veseli – njoftoi se po ndërmerre një nismë për ndryshimin e ligjit mbi të cilin bazohet gjykata.

PDK-ja propozoi që procedurat gjyqësore të vazhdojnë deri në përfundimin e fazës së apelit. Megjithatë, nëse çështja dërgohet për rigjykim, ajo nuk duhet të nisë nga e para në Hagë, por në Kosovë.

Në rast të një rigjykimi të mundshëm, "zbatohet juridiksion i ri dhe, pasi të plotësohen kushtet, çështja do të transferohet në Kosovë për procedim", u tha mediave të hënën kreu i PDK-së, Bedri Hamza.

Ai argumentoi se protestat nuk mund të shpërfillen, duke thënë se "Kuvendi i Kosovës nuk mund të sillet sikur kjo çështje nuk e prek Republikën e Kosovës".

Nuk është ende e qartë se sa mbështetje do të marrë propozimi i PDK-së. Por zemërimi për vendimin ndahet edhe nga partia në pushtet, Vetëvendosje. Kryeministri Albin Kurti, lideri i Vetëvendosjes, shkroi të hënën në X se konstatimet e gjykatës "u bazuan në pasaktësi faktike, keqkuptime historike dhe gabime ligjore. Presim që këto të korrigjohen plotësisht në apel".

Dhomat e Specializuara u themeluan në bazë të një ligji të miratuar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës, nën presionin e aleatëve perëndimorë të Prishtinës. Gjykata është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por ndodhet në Holandë dhe përbëhet nga gjyqtarë ndërkombëtarë, si pjesë e përpjekjeve për të parandaluar ndërhyrjet te dëshmitarët gjatë gjyqeve. Thaçi ishte një nga politikanët që mbështetën themelimin e gjykatës, duke thënë se ajo do të provonte se lufta e UÇK-së ishte e drejtë.

Ish-Avokati i Popullit i Kosovës, Hilmi Jashari, tha për BIRN të premten se ndryshimi i rregullave për emërimin dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve në Dhomat e Specializuara të Kosovës do të ishte i dobishëm për garantimin e një gjykimi të drejtë. Por Jashari paralajmëroi se kërkesat për shfuqizimin e plotë të ligjit për gjykatën nuk do të ishin rruga e duhur përpara.

"Kam dëgjuar kohët e fundit se zgjidhja e vetme është shfuqizimi i ligjit që rregullon Dhomat e Specializuara; më pas dëgjohej propozime që presidenti duhet t'i falë individët e dënuar, por, duke folur praktikisht, ndërmarra e një nisme të tillë është e pamundur nga pikëpamja ligjore dhe juridike", tha Jashari për programin televiziv *Kallxo Përnime* të BIRN-it dhe Interneës Kosova-s të premten.

Edward P. Joseph, pedagog në Shkollën e Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare të Universitetit Johns Hopkins në Uashington, D.C., tha për *Kallxo Përnime* se zemërimi ndaj gjykatës në Kosovë është i kuptueshëm – veçanërisht pasi vendimi vjen menjëherë pas varrimit me nderime ushtarake në Beograd të gjeneralit serb të Bosnjës gjatë luftës, Ratko Mlladiç, i cili ishte dënuar për gjenocid.

"Si rrjedhojë, ky vendim u duket serbëve në Beograd si një lloj shfajësimi ose faljeje, ndërsa hedh një hije mbi realitetet e viteve '90 në Kosovë. Për këtë arsye, e konsideroj shumë shqetësues", tha Joseph, duke pretenduar se Serbia dhe mbështetësit e saj në Rusi dhe Kinë do ta shfrytëzonin vendimin për të përhapur narrativat e tyre.

Ministri i Brendshëm i Serbisë, Ivica Daçiç, e ka mirëpritur vendimin fajësues pikërisht në këtë mënyrë, duke thënë se ai përbën një "konfirmim të qartë, ndonëse shumë të vonuar, të asaj që Serbia dhe populli serb kanë thënë me zë të lartë për më shumë se një çerek shekulli – se e ashtuquajtura UÇK ishte një organizatë kriminale dhe terroriste".

Ndërkohë, të hënën në mbrëmje në Prishtinë, protestuesit u mbledhën sërish në sheshin kryesor, të vendosur që mesazhi i tyre të dëgjohet.

Etiketa: Dhomat e Specializuara | Gjykata Speciale | Hashim Thaçi | Kosovë | Protesta | UCK

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.